



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
DREJTORIA E BUJQESISE, ADMINISTRIMIT TE PYJEVE,
UJRAVE DHE SHERBIMIT VETERINAR

**RAPORT MBI MONITORIMIN E ZBATIMIT TE BUXHETIT PER 4-
MUJORIN JANAR-PRILL 2019**

**A. DREJTORIA E BUJQESISE, ADMINISTRIMIT TE PYJEVE , UJRAVE DHE SHERBIMIT
VETERINAR,**

- ❖ *Programi i Mirëmbajtjes së kanaleve ujitse dhe kulluese*
- ❖ *Planifikimit te mbrojtjes dhe shtimin e siperfaqes pyjore*
- ❖ *Programi i sektorit te bujqesise*

Emertimi i shpenzimit	Plan Buxhet vjetor 2019	Plan Buxhet 4/mujor 2019	Realizimi 4 mujor Janar-Prill 2019	% e realizimit
600+601	23671	7302	7066	96.7
602-609	1533	7502	3945	53
230-231	350	350	279	80
Totali	25554	15154	11290	75

1* Administrimi,shfrytezimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit

Realizimi i shpenzimeve sipas dy zërave kryesor, krahasuar me planin vjetor të rishikuar, rezulton si më poshtë:

Sipas ndarjes ekonomike paraqen keta tregues te permbedhur te realizimit te buxhetit:

000/ leke

Emertimi i shpenzimit	Plan Buxhet vjetor 2019	Plan Buxhet 4/mujor 2019	Realizimi 4 mujor Janar-Prill 2019	% e realizimit
600+601	3294	1212	1150	95
602-609	12959	5528	2631	48
230-231	350			
Totali	16603	6740	4060	60

Shpenzimet korente, plani vjetor 16 603 000 leke,
 plani 4- mujorit te pare, **6 740 000 leke**
fakti 4- mujorit te pare 4 060 000 leke
realizimi 60%.

Artikulli 600+601, shpenzime personeli është realizuar në masën 95% ,numri i punonjësve si në vitin 2018 dhe në vitin 2019 ka qenë 5 punonjës. Janë derdhur rregullisht kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, tatimi mbi të ardhurat personale duke mos krijuar borxhe dhe deficit pranë organeve tatimore.

Artikulli 602+609, shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes janë realizuar në masën 48%. Janë likuiduar detyrimet e trashëguara nga viti 2018 , për të cilat kishim fonde por nuk u likuiduan për shkak të limit të vendosur në thesar, janë shlyer rregullisht detyrimet ndaj të tregëtisë si ndaj OSHEE, Ujesjelles kanalizimeve, shpenzimet telefonike dhe interneti. Mosrealizimi ka të bëjë me planifikimin e prokurimeve për blerje karburant për shërbime për mjetet e transportit , janë me kontrata deri në fund të vitit 2019 dhe likuidimi do bëhet sipas afatave të kontratave.

Janë për të tenderuar nga Bashkia 2 tendera :

Mirëmbajtjen e mjeteve të transportit për drejtorinë me vlerë 2.100.000 leke

Dhe blerje karburanti në vlerën 2.000.000 leke

Politika e Programit, konsiston në ofrimin e një infrastrukture sipas standardeve bashkëkohore në të gjithë komponentët e saj, të shtrirë në të gjithë territorin e Bashkisë Berat, me qëllim që t'iu mundësojë fermerëve ujë dhe kullim normal në çdo parcele toke , krijimin e kushteve infrastrukture dhe organizative për një mirëmbajtje të vazhduar të sistemit të kanaleve ujë dhe kulluse. Në ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Neni 27, Funksionet e bashkive në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit, parashikohet që “Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve, pikë 1: Administrimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujë dhe kullimit, të transferuar në pronësi të tyre, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj”. Vendimi i Këshillit të Ministrave, Nr.1108, datë 30.12.2015, “Transferimi nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të bashkitë, të infrastrukturës së ujë dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të bordeve rajonale të kullimit”, ka kaluar në administrim të Bashkisë , që ndjek politikën vendore, harton programin e ndërhyrjes, termit e referencës dhe standartet, funksionon edhe Drejtoria e Administrimit të pyjeve dhe Ujërave dhe Shërbimit Veterinar me sektorin e Ujës dhe Kullimit e përbërë nga 5 punonjës, teknikë dhe punëtorë të cilët kanë detyrë të kryejnë dhe të ndjekin në territor zbatimin e punimeve që kryhen për pastrimin e kanaleve ujë dhe kulluse. Me kalimin e funksionit të ujës dhe kullimit, sipas ligjshmërisë të paraqitur më sipër, duhet të ndërhyhet me pastrime dhe riparime sipas nevojës dhe rast pas rasti në kanale ujë dhe kulluse në të gjithë territorin e Bashkisë së Beratit. Ndërhyrja për pastrimin e kanaleve kulluse siguron mbajtjen në nivelet optimale të ujërave duke eliminuar si dëmtimin e bimeve të mbjellura nga fermerët ashtu edhe të strukturës së tokës në vetvete. Ndërhyrja në pastrimin dhe mirëmbajtjen e kanaleve ujë dhe veprave të artit që sigurojnë mirëfunksionimin e tyre, është e domosdoshme për të bërë të mundur realizimin e rendimenteve të parashikuara nga fermerët për kulturat e ndryshme bujqësore. Ndërhyrja në mirëmbajtjen e argjinaturave, përveç mbajtjes nën kontroll të tyre, parashikon dhe mirëmbajtje të pjësëshme sipas rregullores së mirëmbajtjes së veprave të mbrojtjes nga lumenjtë. Përsa i përket kanaleve vaditëse për të gjitha njesitë administrative të bashkisë së Beratit janë ngritur **5 shoqata** sipas ligjit në fuqi për mirëmbajtjen e kanaleve dhe shpërndarjen e ujë për vaditje të fermerët .

Aktivitetet kryesore të projektit

1. Evidentimi në vazhdimësi i problematikave kryesore të sistemit ujitës dhe kullues
2. Hartimi i planeve të ndërhyrjeve për pastrim dhe rehabilitim Kanaleve Ujitëse dhe Kanaleve Kulluese.
3. Përcaktimi i vëllimeve të punës në objektet ku do të ndërhyhet.
4. Kryerje e punimeve për pastrimin dhe rehabilitimin e kanaleve ujitëse dhe kanaleve kulluese në të gjithë territorin e bashkisë Berat dhe njesitë Administrative.

Objektivat e Ujitjes dhe kullimit

- **Objektivi 1**
- Shfrytëzon dhe mirëmban infrastrukturën e ujitjes dhe kullimit të transferuar në pronësi, që të plotësojë nevojat për ujë për ujitje, të llogaritur ujë dhe të parandalojë grumbullimin e ujit, zhvillimin e kripëzimit dhe toksifikimit.
- **Objektivi 2.**
- Shfrytëzon dhe mirëmban infrastrukturën e ujitjes, në mënyrë të tillë, që çdo fermer të marrë ujë në kohën dhe sasinë e kërkuar.
- **Objektivi 3**
- Pastron dhe mirëmban kanalet kulluese dhe ujitës;
- **Objektivi 4**
- Rehabiliton dhe rikonstruktin infrastrukturën e ujitjes dhe kullimit si dhe veprat e mbrojtjes nga përmbytja në zonat e banuara;
- **Objektivi 5**
- Monitoron sasinë e ujit që përdor gjatë një viti.
- **Objektivi 6**
- Mbikëqyr sigurinë e digave të rezervuareve për ujitje dhe kur është e nevojshme kryen ndërhyrje emergjente të mirëmbajtjes apo rehabilitimit për garantimin e sigurisë së tyre;
- **Objektivi 7**
- Merr masa për kontrollin e cilësinë e ujit për ujitje dhe të ujit, që kullohet;
- **Objektivi 8**
- Monitoron sasinë e ujit që përdor gjatë një viti.

2-Programi i planifikimit të mbrojtjes dhe shtimit të sipërfaqes pyjore

Realizimi i shpenzimeve sipas dy zërave kryesor, krahasuar me planin vjetor të rishikuar, rezulton si më poshtë:

Shpenzimet korente, plani vjetor	5.649. 000 leke,
plani 4- mujorit të parë,	2.399 000 leke
fakti 4- mujorit të parë	2 .130 000 leke
realizimi	88%.

Përshkrimi i programit:

Kosiston ne marrjen e masave per eleminimin e erozionit, krijimin e nje mjedisi sa me te paster, uljen e ndotjeve te ajrit etj. Pyllzime te reja,sistemime malore,trajtime silvikulturore ne Njesite Administrative Velabisht,Otlak,Roshnik,Sinje.

PYJE DHE KULLOTA

- **Objektivi 1**
- Mbrojtja e sipërfaqeve pyjore /kullosove/shërbimi pyjor sipas mënyrës së përcaktuar në ligj.
- **Objektivi 2**
- Administrimi i shërbimit të pyjeve dhe kullotave në Bashkinë Berat
- **Objektivi 3**
- Mbledhje e informacionit /pergatitje materialesh per realizimin e rishikimit/hartimit te Planit te menaxhimit per Bashkine Berat .
- **Objektivi 4**
- Rehabilitimi dhe pyllëzimi i sipërfaqeve pyjore/kullosove, të degraduara, djegura si edhe mbrojtja e tokes nga erozioni (Projektim/Investim).
- **Objektivi 5**
- Hartim projekte teknike për Pyllëzim sipërfaqe pyjore në territorin e Bashkise Berat dhe krijimin e sinjalistikes ne zonat pyjore .Ndërtim prita malore .

Sipas ndarjes ekonomike paraqen keta tregues te permbedhur te realizimit te buxhetit:

000/ leke

Emertimi i shpenzimit	Plan Buxhet vjetor 2019	Plan Buxhet 4/mujor 2019	Realizimi 4 mujor Janar-Prill 2019	% e realizimit
600+601	4275	1025	946	93
602-609	1374	1374	1184	86
230-231				
Totali	5649	2399	2130	88

Artikulli 600+601, shpenzime personeli eshte realizuar ne masen 93% ,numri i punonjesve si ne vitin 2018 dhe ne vitin 2019 ka qene 5 punonjes. Jane derdhur rregullisht kontributete e sigurimeve shoqerore e shendetesore, tatimi mbi te ardhurat personale duke mos krijuar borxhe dhe deficit prane organeve tatimore.

Artikulli 602+609, shpenzimet operative dhe te mirembajtjes jane realizuar ne masen 88% .

Struktura e Pyjeve ne drejtori ka 5 punonjes midis tyre 2 inxhinier pyjesh dhe te cilet mbulojne te gjithe territorin e bashkise Berat me nje siperfaqe 16.201 ha pyjesh .Inspektime ne te gjithe zonen jane kryer per 4 mujorin nga te cilat ka pas dhe konfiskime te lendeve drusore te ndryshme te cilat jane depozituar prane kesaj drejtorie ne 35 mst (Lis dhe mare). **Me vlere 66.000 leke lis dhe 32.500 lek mare. Te ardhura nga sektori i pyjeve dhe kullotave per buxhetin e bashkise per 4 mujorin e vitit 2019 nga nga qera eshte 565 000 leke .**

Per vitin 2019 DBAPU&ShV ka furnizuar Drejtorine Ekonomike Te Arsimit dhe popullaten e qytetit me dru mare nje sasi 410 m3 me vlere 672.500 leke .

Per vitin 2019 me vendim te Keshillit Bashkiak Nr 36 date 26.02.2019 u shtuan 6 punonjes me kontrate 6- mujore “ Roje Sezonal pyjesh”

Struktura e e pyjeve dhe mbrojtjes nga zjarri per 4 mujorin 2019 ka bere kontrole te perseritura ne parandalimin e zjarre ne kullota e pyje dhe per rastes kur ka pas sinjalizime per zjarre ka qene gjithe kohen ne gadishmeri dhe ka pas rezultate shume te mira ne fikjen dhe mosperhapjen e zones perreth..

3. PROGRAMI I SEKTORIT TE BUJQESISE

Ky sektor eshte i fokusuar ne zbatimin e VKM 994 DT 09.12.2015 “Per procedurat e regjistrimit te akteve te marrjes se tokes ne pronesi.” Ky realizim vjen si rezultat i bashkpunit me ZVRPP dhe prefektura.

Realizimi i shpenzimeve sipas dy zërave kryesor, krahasuar me planin vjetor të rishikuar, rezulton si më poshtë:

Shpenzimet korente, plani vjetor 17 145 000 leke,
plani 4- mujorit te pare, 5 708 000 leke
fakti 4- mujorit te pare 5 143 000 leke
realizimi 90%.

Sipas ndarjes ekonomike paraqen keta tregues te permbledhur te realizimit te buxhetit:
000/ leke

Emertimi i shpenzimit	Plan Buxhet vjetor 2019	Plan Buxhet 4/mujor 2019	Rrealizimi 4 mujor Janar-Prill 2019	% e realizimit
600+601	16102	5065	4970	98
602-609	1000	600	130	21
230-231	43	43	43	100
Totali	17145	5708	5143	90

Artikulli 600+601, shpenzime personeli eshte realizuar ne masen 99%, .Jane derdhur rregullisht kontributete e sigurimeve shoqerore e shendetesore, tatimi mbi te ardhurat personale duke mos krijuar borxhe dhe deficit prane organeve tatimore.

Artikulli 602+609, shpenzimet operative ,Mosrealizimi ka te bej me planifikimin e prokurimeve per blerje Certifikata Veterinare ne muajin Prill 2019 e cila do pasqyrohet ne likujdim ne 4 mujorin e dyte .

Sektori i Bujqësisë

Për perjudhën Janar – Prill 2019 ne si sektor me anë të sp. kadastrës pranë kësaj drejtorie, kemi punuar maksimalisht për tju dhënë zgjidhje sipas procedurave ligjore, të gjitha problemeve që na janë paraqitur pranë drejtorisë tonë apo në Nj. Administrative, si nga fermerët ashtu dhe nga institucionet e tjera si ZVRPP Berat, Prefektura Berat, Ministria e Bujqësisë, Qarku Berat, Projekti TAP etj.

Fondi i tokë bujqësore gjithsej si Bashki = 14764 Ha nga kjo:

Tokë shtetërore = 3324 Ha

Tokë e **kultivuar = 11440 Ha (mar me ligjin 7501)** nga kjo mbjellë me kulturat si më poshtë:

- Ullishte 3724 ha
- Pemë frutore 1143 ha
- Vresht 653 ha
- Bimë arash 5920 ha (drithra, perime, foragjere etj.)

Nga ana jonë janë trajtuar të gjitha kërkesat e paraqitura dhe sipas rastit kemi dërguar kërkesë për plotësim dokumentacioni ZVRPP Berat, fermerëve apo institucioneve të tjera.

Kontrolli dhe siguria ushqimore per konsumatorët

D.A.P.U&ShV ka ne organiken e saj dhe 3 Veteriner te cilet mbulojne te gjithë territorin e bashkise Berat per te bere kontrole te vazhdueshme per mbrojtjen e konsumatorit

Objektivi 1 :

Mbrojtja e konsumatorit

Sherbimi Veterinar prane Bashkise Berat pjese perberese e Drejtorise se Bujqesise „Administrimit te Pyjeve ,Ujrave ne mbeshtetje te ligjit Nr.10465 date 29.09.2011 " Per sherbimin veterinar ne Republiken e Shqiperise ",Ligjit Nr.87/2012 " Per miratimin e aktit normativ te Keshillit te Ministrave ne fuqine e ligjit nr.4 date 16.08.2012 " Per percaktimin e rregullave per therjen e kafsheve dhe tregtimin e mishit te tyre" si dhe ne akte nenligjore te rrjedhura prej tyre ,ne Vendimin e Keshillit Bashkiak nr .11 date 20.01.2016,VKB Nr.3 date 20.01.2016,ka qene ne aktivitet te vazhdueshem per arritjen e qellimit themelor per mbrojtjen e konsumatorit nga semundjet zoonoze te transmetueshme nga konsumi i produkteve e nenprodukteve shtazore si dhe kontaktit me kafshet e gjalla.

Objektivi 2

Inspektime dhe ushtrim te kontroll ne subjektet e thertoreve si me poshte :

Gjithashtu eshte kryer kontrolli i kafshes e shoqeruar me matrikull dhe certifikaten e levizjes ,kontrolli mjekesor para dhe pas therjes,rregjistrimi i tyre ne rregjistrin e para therjes,pajisja e karkases me vulen sanitare,mbajtja e karkases ne dhoma frigoriferike te pakten 6-8 ore ,

Ne zbatim te Ligjit nr .10465 date 29.09.2011 si dhe vendimit te keshillit bashkiak nr .11 date 20.01.2016,kemi si qellim inspektimin per cdo rast konstatimi si

-Shitja e produkteve dhe nenprodukteve shtazore dhe blegtorale ne njesi tregtare te pamiratuara nga institucionet perkatese.

-Shitja e peshkut ,mishit ,vezeve ,qumeshtit dhe cdo produkti tjeter blegtoral ne rruge ,trotuare dhe hapsira te tjera publike.

-Shitja e mishit pa kontroll ne thertore .

- Mbajtja e kafsheve shtepiake te pa rregjistruara ne Inspektoriatin Veterinar te Bashkise .

-Mbajtja dhe levizja ne hapsirat e qarkullimit publik te kafsheve te luksit si qen ,ari etj, pa masa mbrojtese.

- Mbajtja e bagetive ,gjedh ose te imta ,shpendeve ,lepujve ,blete ne hapsira publike ose private ne territorin e Bashkise .

Cdo rast i tille konstatimi perben kundravajtje administrative .Sipas rastit te caktuar sherbimi veterinar per te arritur qelimin e inspektimit ka qen ne bashkepunim te vazhdueshem me Policine Bashkiake ,AKU (Autoriteti Kombetar i Ushqimit) ,Drejtore Rajonale te Bujqesise etj.

Objektivi 3

Rregjistrimi i kafsheve te therura ne rregjistrin e therjes dhe raportimi i te dhenave ne sistemin Ruda.Gjithashtu dhe pajisjen e lekurave me certifikaten perkatese dhe dergimi i tyre ne pikat e grumbullimit.

Gjate 4 mujorit ata kane arritur te japin certifikata veterinare gjithsej 8100 cope per kafshe te tipit gjedh dhe te imta te cilat kane kaluar si te ardhura ne buxhetine bashkise Berat ne vleren **700.000 leke** .

DREJTORI

Rajmond Abazi